



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGETARE

URDHER

Nr. 9/11 Date 4.12 2007

PER DEPOZITIMIN E STATUTIT TE
SH.A. " UJESJELLES KANALIZIME" LIBRAZHD

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 " Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare" ndryshuar me Dekretin Nr. 1195 date 14.08.1995, Ligjin Nr 8158, date 07.11.1996, ndryshuar me Dekretin Nr. 3318, date 30.04.2002, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, VKM 678, date 03.10.2007 dhe nenit 128 te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", me cilësinë e aksionerit te vetëm

URDHEROJ :

1. Depozitimin e statutit te ndryshuar te shoqërisë Sh.A. " Ujësjetllës Kanalizime" Librazhd.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare për kryerjen e veprimeve përkatëse ne përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit" Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36.

Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.



MINISTRI

GENCRULI

AKT -THEMELIMI I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date _____, ne baze te Ligjit Nr.8237, date 1.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr.1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr.8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr.1631, date 1.11.1996 dhe Ligjin Nr.8158, date 7.11.1996, Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit

VENDOSI:

1. Te krijoje shoqerine anonime "Ujesjellesi " Librazhd Sh.A.
2. Objekti i shoqerise eshte:
 - Prodhim, furnizim dhe shitje uji te pishem
3. Shoqeria do te kete seline e saje ne Librazhd dhe ajo mund te çele dege, filiale agjenci dhe perfaqesi ne te gjitha teritorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratimin e organeve kompetente edhe jashte shtetit.
4. Kapitali themeltar eshte 51.260.000 leke i ndare ne 51.260 aksione me vlere nominale 1000 leke.
5. Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.
6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga :
 - Xhorxhi BUCKA
 - Arqile BASHA
 - Qirjako ZALLOTA
7. Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.
8. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themeluese.

ZV. MINISTRI
[Signature]
PAJTIM BELLO


